

STATUTI
SHOQERISE TREGTARE
"SEMAN2SUN" sh.p.k.

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sipas kerkesave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe atij nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", eshte krijuar shoqeria tregtare "SEMAN2SUN" sh.p.k. e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

NENI 2

EMRI & ORTAKET

2.1 Emri i shoqerise:

- Emri i plote "SEMAN2SUN" sh.p.k.
- Emri per te huajt "SEMAN2SUN" sh.p.k. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

2.2 Ortaket e shoqerise

- a) Shoqeria "**OSOJA - ENERGY**" sh.p.k me NIPT **L34131001E**, aksioner me 50% te kuotave te kapitalit, perfaqesuar nga aksioneri i vetem i shoqerise Z. Henri Aleksis.
Dhe
- b) Shoqeria "**3AD Energy**" sh.p.k me NIPT **L61613007U**, aksioner me 50% te kuotave te kapitalit, perfaqesuar nga aksioneri i vetem i shoqerise Z. Arben Goga.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise ndodhet ne fshatin Sheq Marinas Topoje, rrethi Fier, me numer pasurie 556/2, Zona Kadastrale 3358.

Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.



NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

“Implementimi dhe menaxhimi i projektit gjenerues te energjise elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihrmese ne Zonen Topoje, Bashkia Fier, bazuar ne Autorizimin Paraprak me Nr. 4296/7 Prot., date 10.10.2017, leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise ne favor te shoqerise “OSOJA ENERGY” sh.p.k. Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licensave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes”.

NENI 5
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit te shoqerise eshte i perhershem.

NENI 6
KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet nga kontributi ne para i dy ortakeve themelues. Ai perbehet nga 2 kuota. Kontributi ne para do te kete vleren prej 10.000 (dhjetemije) leke.

Ky kapital themeltar i shoqerise eshte ne kete pjesemarje:

- Shoqeria “OSOJA - ENERGY” sh.p.k. zoteron 50% (njezet perqind) te kuotave te kapitalit themeltar, pra 1 (nje) kuote te barabarta ne vlere me 5.000 (pesemije) leke, si kontribut per themelimin e shoqerise.
- Shoqeria “3AD Energy” sh.p.k. zoteron 50% (njezet perqind) te kuotave te kapitalit themeltar, pra 1 (nje) kuote te barabarta ne vlere me 5.000 (pesemije) leke, si kontribut per themelimin e shoqerise.


Kapitali themeltar eshte derdhur ne total nga ortaket themelues ne ditën e sotme. Vleresimi dhe pagesa e kapitalit themeltar eshte kryer nga ortaket me miratimin e ketij Akti.

Kapitali i shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros, detyrimet e ortakeve, huara dhe instrumenta te tjera, dhe te tjera pasuri te nevojshme te luajteshme apo te paluajteshme per ushtimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 7
PRONESIA MBI KUOTAT

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakeve. Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nepermjet:

- Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- Shit-blerjes;



- Trashegimise;
- Dhurimit;
- Ne cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

NENI 8

FITIMI APO KALIMI I KUOTAVE

Ortaku mund te shese te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen sipas ligjit, ndryshe jane te pavlefshme.

NENI 9

HEQJA DORE NGA SHOQERIA

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.

NENI 10

ORGANET DREJTUESE

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznensit dhe ushtron aktivitein e saj pas regjistrimit si subjekt tatim pagues.

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar si dhe emri i ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve.

Organet kryesore te Shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

NENI 11

ASAMBLEJA

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor. Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar bilancin vjetor te shoqerise, per percaktimin e politikave tregtare, per ndryshimin e statutit (me $\frac{3}{4}$ e votave), emerimin ose shkarkimin e administratoreve, emerimin ose shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedimet e tjera ndaj administratoreve, riorganizimin ose prishjen e shoqerise.

NENI 12

ORGANI ADMINISTRATIV

Administrimi i shoqerise do te kryhet nga nje Administrator i vetem qe eshte Z. Ardit Kane i biri i Harilla i datelindjes 22.10.1985 me Nr Personal I51022054I.

Administratori i vetem do te qendroje ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare nga dita e rregullimit te statutit.

NENI 13

DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te Shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

Administratori te vetem i takon firma e lire dhe perfaqesimi i Shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seance gjyqesore, si dhe pajtime dhe compromise, pasi te kete marre vendimin e Asamblese.

Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.

Kompetencat kryesore te Administratorit te shoqerise jane:

Te hartoje planet e llogarive ekonomike.

Te hartoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.

Te perfaqesoj Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj.

Te percaktoj strukturat e aparatit te shoqerise dhe te krijoj organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise.

Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit.

Te percaktoj numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

Te vendose rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta), etj;

Te perfaqesoj shoqerine ne regjistrin e prones sipas nenit 20 te ketij statuti.

NENI 14

LLOGARITE E SHOQERISE



Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

Transferimi i mjeteve monetare dhe transakcionet financiare do te kryhen ne baze te kriterave te caktuara nga Banka e Shqiperise.

NENI 15

VEPRIMET EKONOMIKO-FINANCIARE

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin; vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne QKR dhe ne organet tatimore e mbyllen ne 31 dhjetor te po atij viti, ndersa vite te tjera ne 1 Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi. Bilancet periodike (mujore, tremujore, gjashtemujore) miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja e ortakeve e nenshkruhen nga administratori dhe depozitohen ne QKR e ne Tatim Taksa. Llogarite vjetore, inventaret, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga Administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga ortaket.



Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet Brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar per tre vite financiareme mundesi rizgjedhjeje, nga ortaket.

Shkarkimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

NENI 16

DEBIT NE KAPITAL

Ne rastet kur ortaket jane debitore per kapital te paderdhur sipas % te pjesemarjes ne kapital, fitimi neto do te kaloje per shlyerje te detyrimit deri ne masen e plotesimit te % te pjesemarjes.

NENI 17

MAREDHENIET E PUNES

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert zgjidhja behet ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

NENI 18

DISPOZITA TE VECANTA

Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkak, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregetar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.

Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortaket emerone nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e Aktivit dhe Pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.


Ne fund te procesit te likujdimit, Ortaket vendosin mbi Bilancin perfundimtar financiar,. Mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbyllje si pjese e likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeve te kapitalit themeltar tek kontribuesi perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortaket.

NENI 19

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit themelimit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane, ne baze te ligjit nr.9723 date 03.05.2007.



NENI 24

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do ti behet referim ligjit Nr 9901 date 14/04//2008 "Per Tregetaret dhe Shoqeriste Tregetare" si dhe legjislacionit koherent. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 25

Ky statut u perpilua ne prani te Ortakeve duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.

Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila per t'u depozituar ne QKR e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET

Shoqeria:

"OSOJA - ENERGY" sh.p.k

ORTAKU I VETEM

Z. Henri Aleksis.



Shoqeria:

"3AD Energy" sh.p.k

ORTAKU I VETEM

